



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:243029
Datë: 10.05.2024
Numri i dokumentit: 05667949

C-IV-14-5991

Parashtruesi i kërkesës

G S fshati D, Podujevë

Pala kundërshtare

NSH “K.B Flora”, e përfaqësuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, Rr. “Dritan Hoxha” nr. 55, Lakrishte, Prishtinë

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), gjyqtarja Manushe Karaqi me 8 maj 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- REFUZOHET** ankesa si e pabazuar.
- VËRTETOHET** vendimi i Autoritetit të Likuidimit Nr.PRN017-0089, i datës 22 korrik 2014, si i drejtë dhe i bazuar në ligj.
- Nuk caktohen taksa gjyqësore për Ankuesin.

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 28 gusht 2014, paditësi ka parashtruar ankesë ndaj Vendimit të Autoritetit të Likuidimit me numër PRN017-0089, i datës 22 korrik 2014, me të cilin është refuzuar kërkesa e paditësit për kompensimin e pagave të papaguara në periudhë dhe shumë të pa specifikuar.

Parashtruesi ka theksuar se ka qenë në marrëdhënie pune të rregulltë në NSH “K.B Flora”, nga data 23 qershor 1988 deri me 19 janar 2012. Andaj, ka propozuar që Gjykata ta shqyrtoj Vendimin e lartcekur dhe të njëjtin ta Ndryshojë ashtu që parashtruesit t’ia bëjë kompenzimin për tri paga të papaguara në shumë prej 250 euro , në muaj, për 10 paga të papaguara ose Vendimin ta Anuloj dhe lëndën ta kthej ne rishqyrtim dhe rivendosje Autoritetit të Likuidimit.

Parashtruesi e ka bashkangjitur Vendimin e Autoritetit të Likuidimit me numër PRZ017-0089, Vendimin mbi zgjedhjen e kandidatit sipas shpalljes si dhe Vërtetimin për përvojën e punës.

Ne Vendimin e lartcekur, Autoriteti i Likuidimit ka konstatuar se parashtruesi e ka pranuar letrën në bazë të cilës është kërkuar të dorëzojë informata dhe dokumentacionin shtesë në mbështetje të kërkesës së tij, mirëpo nuk k dorëzuar asnjë përgjigje.

Tutje në vendim AKP-ja i referohet Nenit 36.2 të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034 për AKP-në, i cili parasheh që: "...elementet në vijim përbëjnë bazë të mirë dhe të mjaftueshme sipas këtij ligji për refuzimin e një Kërkesë apo interesi të pretenduar të kapitalit apo pronësisë:...kërkesa apo pretendimi është i parashkruar sipas kufizimeve kohore të aplikueshme".

Më 24 tetor 2022, parashtruesi e ka paguar taksën gjyqësore në shumë prej 20 euro.

Më 26 mars 2024, AKP-ja dorëzoi mbrojtjen e saj ndaj ankesës së parashtruesit kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit me numër PRN017-0089 i datës 22 korrik 2014. AKP-ja përmes mbrojtjes theksoi se ka verejtur që në lidhje me parashtruesin ekzistojnë tri vendime të Autoritetit të Likuidimit, mirëpo asnjë nuk korrespondon me ankesën e bashkangjitur në urdhër.

Më 13 mars 2024, Gjykata ka lëshuar një urdhër përmes të cilit iu kërkua parashtruesit që brenda 7 ditëve të dorëzojë në gjykatë Kopjen e Librezës së punës, Njoftimin për ndërprerje të marrëdhënies së punës, Listën e pagave të mbetura borgj si dhe prova tjera shtesë. Pas dështimit të dorëzimit pranimit të dokumentit, në bazë të nenit 26 par. 5 i Ligjit të DHPGJS-së, nenit 116.5 dhe 116.6 të LPK-së, urdhri o datës 13 mars 2024 qëndroi në tabelën e Shpalljeve nga data 16 prill 2024 deri më 24 prill 2024.

Arsyetimi ligjor

Ankesa refuzohet si e pabazuar.

Në bazë të nenit 2.4 dhe nenit 77.1.1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejshëm Ligji për Dhomën e Posaçme), Gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, Gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa nuk e vërtetojnë atë dhe merr Aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Neni 42 pika 2 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtrësia apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese), ndërsa pika 3 parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse pala e tillë dështon që të paraqesë apo dorëzojë provat e tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë.

Sipas nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë t'i paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla.

Sipas AKP-së, ekzistojnë tri vendime lidhur me ankuesin dhe asnjëra nuk korrespondon me ankesën e ankuesit. Mirëpo, ankuesi në ankesë e ka theksuar numrin e vendimit 8236 te datës 21 korrik 2014 si dhe e ka bashkangjitur vendimin ne fjalë. Ankuesi ka kërkuar nga gjykata që ta shqyrtoj Vendimin e lartcekur dhe të njëjtin ta Ndryshojë ashtu që parashtruesit t’ia bëjë kompenzimin për tri paga të papaguara në shumë prej 250 euro , në muaj, për 10 paga të papaguara ose Vendimin ta Anuloj dhe lëndën ta kthej ne rishqyrtim dhe rivendosje Autoritetit të Likuidimit. Mirëpo në vendimin e bashkangjitur kërkesa e tij është refuzuar për kompensimin e pagave të papaguara në shumë dhe periudhë të papërcaktuar.

Në këtë rast, ankuesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi relevante që dëshmon se NSH i ka borxh detyrimin e pretenduar për paga të papaguara konform nenit 40, paragrafi 1.6.2., të Shtojcës së Ligjit mbi AKP-në. Si rrjedhojë, Ankuesi nuk ka dorëzuar ndonjë dëshmi që do të vërtetohej se ndërprerja e marrëdhënies së punës të ankuesit ka ardhur si pasojë e ndonjë veprimi të Agjencisë.

Duke u bazuar në nenin 10 të Ligjit për Dhomën e Posaçme si dhe nuk e ka mbështetur me një listë të dëmeve që përcaktohet me nën-paragrafin 2.5. të këtij neni në rast se Dhoma e Posaçme vendos se nuk mund, ose nuk do të caktojë një kompensim të tillë jo-financiar.

Gjykata gjen se në mungesë të dëshmive, pretendimet e Ankuesit lidhur me të drejtën e tij për kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, nuk janë të mbështetura me provat e nevojshme materiale, prandaj si të tilla janë refuzuar si të pabazuara.

Andaj në bazë të së lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54.1 dhe 74.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Taksat gjyqësore

Në bazë të nenit 62.5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme secila palë do t’i mbulojë shpenzimet e veta.

Këshilla juridike

Kundër këtij Aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij Aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Gjyqtare
Manushe Karaqi